

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-24294

Dt. 29.12.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Muharrem Vraniqi** nga Gjakova, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare, me etazhitet P+0, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97 bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: aplikuesëve: **Muharrem (Ramadan) Vraniqi dhe Eduard (Rexhep) Vraniqi**

nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare, sipas projektit kryesor të prezentuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Vendimin për Kushte Ndërtimore me nr. 07-351/01-21718, të datës 06.11.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me numër 262-29 , Z.K. Jahoc, në pronësi të lartë përmendurve (nga $\frac{1}{2}$ e pjesës ideale) cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objekteve në fjalë, etazhiteti i objekteve është P+0 , me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit $S= 111.80 \text{ m}^2$.

Përdhesa: (Sip,Bruto): $S= 111.80 \text{ m}^2$

II. Hartimin e projektit kryesor me destinim: ndërtimi i objektit të banimit individual, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese ndërtimore “Real PROJECT” - Gjakovë.

Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

III. Investitori është i obliguar që:

- Të ruaj një ekzemplar original të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Pa pëlqimin e hartuesit të projektit ideor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve;

IV. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Muharrem (Ramadan) Vraniqi nga Gjakova, me banim në rrugën: SADIK POZHEGU p.n., ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-24294 të datës 11.12.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual – shtëpi familjare, me etazhitet P+0, në ngastrën kadastrale me nr. 262/29, Z.K. Jahoc, siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 19.10.2017, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 11.10.2017 (fotokopje) në pronësi të Muharrem (Ramadan) Vraniqi dhe Eduard (Rexhep) Vraniqi ga Gjakova, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme (fotokopje) me numër të lëndës 1804/17, të datës 11.10.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Vendimi për Kushte Ndërtimore, me nr. 07-351/01 – 21718 të datës 06.11.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të banimit individual, në ngastrën kadastrale me nr. 262-29, ZK: Jahoc, të lëshuar nga DUMM.
5. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430/a/307, të datës 12.10.2017.
6. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr.2001 të datës 05.12.2017.
7. Pëlqimin nga K.R.U. "Radoniqi" Sh.A.Gjakovë, nr.3250 të datës 24.11.2017.
8. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, dt. 21.11.2017.
9. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Postën e Kosovës, filiali Gjakovë me datë 28.12.2017.
10. Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga ndërmarrja projektuese ndërtimore "Real PROJECT"- Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 529.75 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:


- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit,
- Arkivit.

Zenel Shabani
Zenel Shabani, jur. i dipl.

Arben Bakalli
Drejtori
Arben Bakalli, jurist

Parcela nr.262/29

PLAN SITUAZIONI



Lokacioni: Muharrem dhe Eduard Vraniqi
 Parc. Kad. 262/29 Z.K. Jahoc
 Etazhiteti P+0 dhe P+1

Punoi:
Fatmir Bobi tek.

Kontrollori:
Durrige Berisha i.d.a.

19.10.2017r.
Takeometri precizno
Auto CAD 2004

P = 1 : 500

Punoi : N.SH. "Geogauss" Gjakovë
DREJTORI
Xhelil Fertini gjecom.

K O P J E P L A N I

Zona kad. Jahoc

Shk. zvog. 1: 1000

Poseduesi: 1 /2 Vraniqi Muharrem (Ramadan), 1 /2 Vraniqi Eduard (Rexhep),
nga Gjakova



Numri rendor i regjistrimit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m	
262/29			pllac		0	03	88	
Gjithësejtë					0	03	88	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastrë duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

Gjakovë 11.10. të vitit 2017

VËRTETON: